



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010) si dhe nenit 21, paragrafi 2, dhe nenit 22, paragrafi 7, të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018 miratoi këtë:

Rregullore për themelimin e pensionit plotësues individual nga ofruesit e pensionit

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat, parimet dhe udhëzimet për themelimin e Pensionit Plotësues Individual nga Ofruesit e Pensioneve.
2. Kjo rregullore aplikohet për Ofruesit e Pensioneve, të cilët licencohen nga BQK për të ofruar pensionet plotësuese në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (më tej: Ligji për Fondet Pensionale) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1 *Ofrues i Pensioneve (Sigurues i Pensioneve)* - nënkupton institucionet financiare, bankat, instrumentet për investime të hapura dhe kompanitë e sigurimeve që sigurojnë pensionet plotësuese individuale në pajtim me Ligjin për Fondet Pensionale;
 - 1.2 *Përfitues* - nënkupton personin fizik të cilin e ka caktuar pjesëmarrësi, ose kur pjesëmarrësi nuk ka caktuar askënd apo nëse përfituesi i caktuar vdes para pjesëmarrësit, atëherë trashëgimtarët e pjesëmarrësit që janë persona fizikë, janë ose mund bëhen ligjërisht përfitues të mjeteve pensionale që rrjedhin nga të drejtat e pjesëmarrësit;

- 1.3 *Pensionit invalidor* - nënkupton pensionin i cili përfitohet para arritjes së moshës 65 vjeçare nga personi i cili vuan nga paaftësi e kualifikuar dhe që legjislacioni në fuqi i jep atij të drejtën që të filloj pensionin;
- 1.4 *Organet drejtuese* - nënkupton Bordin e Drejtorëve të korporatës e cila është licencuar si bankë, kompani e sigurimeve ose institucion financiar tjetër;
- 1.5 *Mosha e pensionimit* - nënkupton moshën 65 vjeçare;
- 1.6 *Rregullat e Pensionit* - nënkupton dokumentin të cilin e ka përgatitur ofruesi i pensioneve që përcakton kushtet dhe procedurat e sigurimit të kontributeve dhe paraqitjes së kërkesës për beneficione;
- 1.7 *Regjistri i Ofruesit të Pensionit* - nënkupton librin ose regjistrin e mbajtur nga BQK-ja që përmban listën e të gjithë Ofruesve të Pensionit të licencuar dhe kopjet e rregullave përkatëse të pensionit.

Neni 3

Kërkesat e Përgjithshme për Themelimin e Fondit Pensional Plotësues Individual

1. Ofruesi i propozuar i Pensionit duhet të jetë njëra nga institucionet financiare si më poshtë:
 - 1.1 Bankë që është e licencuar nga BQK-ja në pajtim me legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Kosovës;
 - 1.2 Kompani e sigurimit të jetës që është licencuar nga BQK-ja në pajtim me legjislacionin në fuqi për kompanitë e sigurimeve në Republikën e Kosovës;
 - 1.3 Kompani investuese ose kompani për menaxhimin e mjeteve që është licencuar nga BQK-ja si institucion financiar në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Ofruesi i Pensionit dhe organet drejtuese të tij janë fiduciar të pjesëmarrësve individual që blejnë pensionet.
3. Ofruesi i Pensionit duhet që menaxhimin dhe kontabilitetin e mjeteve të pensionit t'i bëjë/mbajë ndaras nga mjetet dhe veprimtaritë e tjera të tij.
4. Ofruesi i Pensionit, përmes organeve drejtuese të tij, përzgjedh Mbajtësin dhe Menaxhuesin e Mjeteve në harmoni me kërkesat ligjore dhe rregullative për Mbajtësit dhe Menaxhuesit e Mjeteve.
5. Ofruesit i Pensionit, aplikon për licencë si Ofrues i Pensioneve në BQK, në pajtim me kërkesat e Rregullores për Licencimin e Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale.

Neni 4

Kërkesat e veçanta për Themelimin e Fondit Pensional Plotësues Individual

1. Rregullat e pensionit të Ofruesit të Pensioneve, të nënshkruara nga organet drejtuese të tij, duhet të përmbajnë si në vijim:

- 1.1 Forma e fondit të pensionit (Shuma e Caktuar ose Kontributi i Caktuar);
 - 1.2 Emri, lokacioni dhe të dhënat e bankës së Ofruesit të Pensionit;
 - 1.3 Kushtet për regjistrimin e individëve si pjesëmarrës në Pension;
 - 1.4 Procedura për dhënien e kontributeve të pensionit dhe obligimet e pjesëmarrësve, nëse aplikohet, duke përfshirë përshkrim të qartë të ndonjë ndëshkimi për dështimin për t'iu bashkuar planit të kontributeve, nëse aplikohet;
 - 1.5 Për Pensionin me Shuma të Caktuara, metodologjia e shfrytëzuar për llogaritje aktuariale për të përcaktuar shumën e kontributeve të kërkuara si dhe procedurat, kohën dhe mënyrën e njoftimit dhe dërgimit të raporteve për pjesëmarrësit lidhur me zhvillimet e menaxhimit të mjeteve të Fondit të Pensionit;
 - 1.6 Për Pension me Kontribute të Caktuara, procedurat për mbajtjen e shënimeve në lidhje me kontributet dhe zhvillimin e investimeve (fitim ose humbje) për shpërndarjen në Llogaritë Individuale të Pjesëmarrësve dhe njoftimin për pjesëmarrësit për shumën në llogaritë e tyre individuale, jo më rrallë se një herë në vit;
 - 1.7 Obligimet e Ofruesit të Pensionit;
 - 1.8 Deklarata e parimeve të investimeve për mjetet e pensioneve, duke përfshirë shpërndarjen e mjeteve, përzierjen, ndarjen (diversifikimin) dhe çështjet tjera, dhe procedurat për zgjedhjen e Menaxhuesit të Mjeteve;
 - 1.9 Procedura për zgjedhjen e Mbajtësit të Mjeteve të pensionit;
 - 1.10 Kriteret, procedurat dhe format e pagesës së pensioneve për pjesëmarrësit, duke përfshirë mundësitë që bashkëshorti që jeton ende të lejohet të tërheqë pensionin; kriteret dhe shumat e benefiteve të tilla dhe të drejtat e përfituesve si dhe natyra e kualifikimit të invaliditetit;
 - 1.11 Kriteret dhe procedurat për transferimin e pjesëmarrësit prej Ofruesit të Pensionit;
 - 1.12 Procedurat dhe formalitetet e kërkuara për plotësimin dhe ndryshimin e rregullave të pensionit;
 - 1.13 Procedurat që kërkohen për ndërprerjen e Pensionit;
 - 1.14 Kërkesa tjera që BQK-ja mund t'i përcaktojë.
2. Deklarata e parimeve të investimeve si pjesë e rregullave të pensionit duhet të përmbajë së paku si vijon:
 - 2.1 Karakteristikat kualitative të investimeve për të ofruar sigurinë dhe profitabilitetin e investimeve;
 - 2.2 Objektivat kuantitative të kthimit në investim dhe mënyra sipas të cilës do të arrihet vit pas viti ky objektivi;
 - 2.3 Limitin maksimal proporcional që mund të vendoset në një lloj të investimit;
 - 2.4 Limitin maksimal proporcional që mund të investohet në një emetues ose në një entitet;

- 2.5 Llojet dhe klasat e investimeve ku mjetet nuk mund të vendosen/investohen;
 - 2.6 Kërkesat minimale të likuiditetit ose dispozitat e kërkuara të investimeve totale;
 - 2.7 Mënyra me të cilën performanca e investimeve raportohet nga organet drejtuese, për pjesëmarrësit dhe BQK-në;
 - 2.8 Koha, shpeshësia dhe mënyra me të cilën organet drejtuese e rishqyrtojnë deklaratën e parimeve të investimit, procedurat e ndjekura për këtë rishqyrtim si dhe procedurat përmes të cilës njoftohen pjesëmarrësit dhe BQK-ja për ndryshimet e bëra gjatë rishqyrtimit.
3. Kompania e licencuar e sigurimit jetësor mundet vetëm të sigurojë program të pensionit duke ofruar pension me shumë të caktuar. Kompania e sigurimit jetësor duhet të plotësojë kërkesat si vijojnë:
- 3.1 Të mirëmbajë vazhdimisht margjinën e solvencës në pajtim me rregullativën e BQK-së për sigurimet jetë;
 - 3.2 Të ketë staf të kualifikuar dhe me përvojë në pensione dhe anuitete;
 - 3.3 Të ketë të angazhuar një aktuar;
 - 3.4 Të llogaritë dhe mbajë provizione teknike për detyrimet që rrjedhin nga programi pensional me shumë të caktuar në pajtim me metodologjitë aktuaristike të përcaktuara në Rregulloren mbi Financimin dhe Vlerësimin Aktuarial të Marrëveshjeve Pensionale me Shuma të Caktuara.

Neni 5

Parimet dhe Udhëzimet për Themelimin e Pensioneve Plotësuese Individuale nga Ofruesit e Pensionit

- 1. Ofruesit e Pensionieve, për themelimin e pensionit individual plotësues, gjatë hartimit të rregullave të tyre të pensionit dhe në zbatimin e programeve të tyre të pensionit, duhet të zbatojnë parimet dhe udhëzimet si në vijim:
 - 1.1 Mjetet e pensionale duhet të mbahen në llogari të veçanta prej mjeteve që iu takojnë veprimtarive tjera të biznesit të Ofruesit të Pensionit, Mbajtësit, ose Menaxherëve të Mjeteve, përfshirë kontabilitetin, mbajtësin, investimet dhe menaxhimin;
 - 1.2 Mjetet e pensionale financohen nga kontributet e individëve dhe të hyrat e investimeve që rrjedhin nga ato. Fondi i mjeteve pensionale duhet të akumulohet në atë mënyrë që të jetë në gjendje të paguajë në mënyrë adekuate premtimet e pensionit. Përveç kësaj, Ofruesi i Pensionit për Pension me Shuma të Caktuara është i obliguar që të mbajë nivelin e financimit në përputhje me detyrimet aktuariale të marrëveshjeve të tij pensionale në çdo kohë dhe që përshtatet me kërkesat e planit të financimit sipas nenit 14 paragrafi 11 të Ligjit për Fondet Pensionale;
 - 1.3 Ofruesi i Pensionit duhet të promovoj vetëm objektivat e programit të tyre të pensionit për të ofruar pensione dhe se mjetet e pensionit janë investuar për të përkrahur ato objektiva. Administrimi dhe menaxhimi i programeve të pensionit duhet të kryhen me transparencën më të

lartë, që kërkon nga organet drejtuese të ofrojë pjesëmarrësve informacion dhe shpalosje të caktuara për mjetet dhe të drejtat e tyre përkatëse;

- 1.4 Investimet, mbajtja dhe shfrytëzimi i mjeteve të pensionit i nënshtrohen mbikëqyrjes për tu siguruar se mjetet e pensioneve shfrytëzohen vetëm për pagesat e pensioneve. BQK-ja ushtron mbikëqyrje mbi biznesin e Ofruesve të Pensionit në të gjitha çështjet në lidhje me skemën e pensionit, investimet dhe Mbajtësin e Mjeteve të Pensioneve. BQK-ja duhet të mbaj Regjistrin e Ofruesve të Pensionit i cili do të jetë publik;
- 1.5 Interesi i pjesëmarrësit në programin e pensionit është e drejta e saj/tij mbi pronën. E drejta e pjesëmarrësit mbi pronësinë se mjeteve pensionale të fituar nga kontributi i tij në programin e pensionit është vënë në dispozicion të saj/tij vetëm për pagesat e pensionit kur ajo apo ai arrin moshën e pensionimit ose në rastet e pensionit invalidor në pajtim me legjislacionin në fuqi, ose për përfituesin(et) e tij në rast të vdekjes para fillimit të pensionit. Pensionet janë të dizajnuara që të sigurojnë të ardhura për të moshuarit.

Neni 6

Zbatimi dhe masat përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 13 mbi Themelimin e Fondit Suplementar Individual nga Siguruesit e Pensionit, e datës 25 korrik 2002.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore